



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura IV**

Kryesia e Kuvendit

P-100

Prishtinë, më 18 mars 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 18 MARS 2013**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

**Nga zyra e Presidentit:** Amir Haradinaj dhe

**Nga OSBE-ja:** Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 mars 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 mars 2013**

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 mars 2013.

### **2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjeve plenare, të filluara më 14 dhe 15 mars 2013, vendosi që ato t'i vazhdojnë punimet të martën, më 19 mars 2013, dhe atë:

**Mbledhja plenare, e filluar më 14 mars, do t'i vazhdojë punimet të martën, më 19 mars 2013, në orën 10:00, me këtë:**

### **Rend dite**

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për blegtorinë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

**Mbledhja plenare, e filluar më 15 mars, do t'i vazhdojë punimet të martën, më 19 mars 2013, në orën 14:00, me këtë:**

#### **Rend dite**

1. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar për rastin “Kiçina”, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Lladrovci, i mbështetur nga deputetët nënshkrues,
2. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Kryesia, me rastin e vizitës së kryetarit të Kuvendit të Madh Kombëtar të Republikës së Turqisë, vendosi që më 20 mars 2013, në orën 11:30, të mbajë seancë solemne, me këtë

#### **Rend dite**

1. Fjalë rasti e kryetarit të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, shkëlqesia e Tij, z. Cemil Çiçek.

#### **Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës**

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet enjten, më 28 mars 2013, me këtë rend dite:

#### **Rend dite**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji,
6. Debat parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
7. Shqyrtimi i raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011,
8. Zgjedhja e një (1) anëtarit të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Gjithashtu, u konstatua se Kryesia në mbledhjen e saj të radhës, më 25 mars, mund ta plotësojë këtë rend dite edhe me pika të tjera, që përgatiten ndërkohë.

### 3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

*1. Ratifikimi i vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë*

Për ratifikimin e vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit; Elmi Reçica, në emër të G/P të PDK-së; Ismet Beqiri, kryetar i G/P të LDK-së, dhe Ardian Gjini, kryetar i G/P të AAK-së; Myzejene Selmani, kryetare e GP/ të KKR-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, nxori këtë:

### P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media si Komision Funkcional që t'i shqyrtojë vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë si institucione publike të arsimit të lartë dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Komisioni për Arsim të njoftohet nëpërmjet transkriptit me diskutimet e zhvilluara në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë.

*2. Debat parlamentar për ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimitarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Kelmendi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues*

Kryesia, kërkesën për debat parlamentar lidhur me ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimitarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Kelmendi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues, e shtyu për mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit.

*3. Propozim-Rregullorja për orarin e punës dhe kompensimet për nëpunësit civilë të Administratës së Kuvendit të Kosovës*

Propozim-Rregullorja për orarin e punës dhe kompensimet për nëpunësit civil të Administratës së Kuvendit të Kosovës u shty për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

*4. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës në Kosovë prej datës 1-4 prill 2013, të kryetares së Këshillit Nacional dhe të Kuvendit Federal të Zvicrës, SH. T. znj. Maya Graf dhe delegacionit të saj*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës së kryetares së Këshillit Nacional dhe të Kuvendit Federal të Zvicrës, Sh. S. znj. Maya Graf dhe delegacionit të saj në Kosovë, prej datës 1-4 prill 2013.

2. Të gjitha shpenzimet me rastin e pritjes së delegacionit të Zvicrës, duke përfshirë akomodimin, drekat/darkat zyrtare, transportin lokal, si dhe shpenzimet tjera shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*5. Kërkesa e deputetëve Adem Grabovci dhe Lutfi Haziri për mbajtjen e Lutjeve të Mëngjesit për pjesën e Evropës Juglindore në Prishtinë, më 24 -26 maj 2013*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga deputetët që kanë parashtruar kërkesë Adem Grabovci dhe Lutfi Haziri që të bisedojnë me përgjegjësit në Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me organizimin dhe koston financiare për Lutjet e Mëngjesit për pjesën e Evropës Juglindore, që do të mbahen në Prishtinë, prej datës 24-26 maj 2013.

*6. Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, prej 4-5 mars 2013*

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të realizuar në Bruksel, prej 4-5 mars 2013.

*7. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, më 21 shkurt 2013*

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, të realizuar në Bruksel, më 21 shkurt 2013.

### **Pika shtesë:**

*1. Njoftimi i deputetit Enis Kervan për lirim të vendit të nënkryetarit të Kuvendit*

Kryesia konstatoi se deputeti Enis Kervan, njoftimin e tij për lirim të pozitës së nënkryetarit të Kuvendit duhet ta parashtrojë zyrtarisht nëpërmjet Zyrës për Propozime dhe Parashtresa të Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*